



## **Mundësi për trajnim**

### **Praktikat moderne dhe të qëndrueshme bujqësore dhe ekonomike për “Promovimin e Fuqizimit të Grave Rurale në Kosovë”**

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën e Mitrovicës në kuadër të projektit “Promovimi i Fuqizimit të Grave Rurale në Kosovë”, shpall thirrjen për ndjekjen e trajnimeve në fushën e bujqësisë. Projekti i zbatuar nga Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO) në bashkëpunim me UN Women dhe i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADC), synon të adresojë barrierat strukturore që pengojnë fuqizimin ekonomik të gruas rurale në sistemet agroushqimore në Kosovë.

Gratë pjesëmarrëse nga Mitrovica do të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre në teknikat moderne bujqësore, praktikat më të mira ekonomike dhe planifikimin efektiv të biznesit.

#### **Përfitimet nga ky trajnim:**

- Mësoni teknikat e avancuara të bujqësisë së mençur dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe praktikat më të mira për të përmirësuar produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve të drejtuara nga gratë ose për të krijuar një agrobiznes të ri.
- Përmirësimi i njohurive për menaxhimin financiar dhe strategjitë e marketingut për të rritur përpjekjet e qëndrueshme të agrobiznesit.
- Udhëzime nga ekspertët për të krijuar një plan biznesi të detajuar, të zbatueshëm, të përshtatur me nevojat dhe objektivat tuaja specifike.
- Bashkëpunimi ekspertë të industrisë dhe gra të tjera rurale për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja.

#### **Thirrja për trajnim është e hapur për:**

- Gra që aktualisht janë të angazhuara në bujqësi, prodhim, përpunim dhe aktivitete tjera
- Gra që operojnë biznese të vogla në sektorin agro-ushqimor
- Gra, veçanërisht vajza të reja që planifikojnë të fillojnë një biznes të ri në fushën e bujqësisë

#### **Si të aplikoni:**

Për të aplikuar për program të trajnimit, pjesëmarrësit e interesuar të plotësojnë një formular të shkurtër aplikim të disponueshëm në zyrën e Drejtorit të Bujqësisë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit tuaj është nga data **19 – 26 gusht 2024**.

Drejtori i Bujqësisë